

NR 316 PROT.  
Dt. 02.07.2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE DHE E  
PËRPUTHSHMËRISË PËR KULTURËN  
DREJTORIA E PROGRAMIMIT, STANDARDIZIMIT DHE HARMONIZIMIT  
TË KUADRIT RREGULLATOR

Nr. 4175/ Prot.

Tiranë, më 02 / 07 / 2018

Lënda: Kthim përgjigje ankimit të Akademisë së Filmit dhe Multimedias Marubi

**Z. KUJTIM ÇASHKU,**  
**AKADEMIA E FILMIT DHE MULTIMEDIAS MARUBI**

Për djeni: **Z. ENGJËLL AGAÇI,**  
**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

**Znj. LINDITA NIKOLLA, MINISTËR**  
**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**

**Z. ILIR BUTKA, DREJTOR**  
**QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË** ✓

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 121, datë 18.06.2018 mbi kërkesën për miratim të projekt marrëveshjes së bashkëpunimit QKK-AFMM, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

**Së pari:** Ministria e Kulturës pasi mori në shqyrtim ankesën e paraqitur nga Akademia e Filmit Marubi, referuar VKM-së nr. 229, datë 26.04.2018 “Për riorganizimin e shkollës së lartë jopublike “Marubi” në Akademi të Filmit dhe Multimedias “Marubi” dhe dhënien e statusit të veçantë të këtij institucioni të arsimit të lartë” njih statusin e veçantë të këtij institucioni të arsimit të lartë, ashtu sikurse njih dhe zbaton Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë si dhe ligjin nr. 8096, datë 21.3.1996, “Për kinematografinë” të ndryshuar. Në këtë kontekst, referuar dispozitave kushtetuese parashikohet parimi i hierakisë së normës juridike si një nga parimet bazë të funksionimit të administratës shtetërore nga ku lind detyrimi, marrëveshjet e çfarëdo lloj natyre qofshin, duhet të hartohen gjithmonë në përputhje me ligjet në fuqi të Republikës së Shqipërisë. Në shqyrtim të parashikimeve të neneve të draft/marrëveshjes të paraqitur nga ju mbi detyrimet e parashikuara për Ministrinë e Kulturës e më konkretisht mbi financimin që kërkohet të aplikohet sipas nenit 23 të draftit, ju bëjmë me dije se kuadri ligjor në fuqi për kulturën nuk parashikon

mbulime/financime për studime specifike për studentët e kinematografisë. Në asnjë rast nuk mund të financohet tarifa e studentit nga Ministria e Kulturës, e cila ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave në fushën e artit dhe kulturës.

**Së dyti:** Në zbatim të ligjit nr. 8096, datë 21.3.1996, "*Për kinematografinë*" të ndryshuar, Qendra Kombëtare e Kinematografisë, vepron si person juridik, publik, me statusin e institucionit qendror, në varësi të Ministrit të Kulturës, ku të ardhurat në përqindje në buxhetin e saj, si dhe statuti i funksionit të saj caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Buxheti i QKK-së është miratuar me ligjin nr. 109/2017 "*Për buxhetin e vitit 2018*" ku në seksionin "*Buxheti 2018 sipas ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore*" kodi 57, në programin 08220 është përcaktuar qëllimi i përdorimit të tij, "*Mbështetja e veprimtarisë kinematografike*".

Qendra Kombëtare e Kinematografisë ka kthyer përgjigje kërkesës tuaj duke parashtruar të gjithë argumentet ligjore në lidhje me formën se si administrohet ky buxhet. Bazuar në ligjin nr. 8096, datë 21.03.1996, "*Për kinematografinë*", të ndryshuar, në përkufizimin e termit producent, ndër të tjera thuhet: "... përjashtohen personat juridikë publikë, të cilët nuk ndjekin qëllim fitimprurës", pra aplikimi në QKK duhet të bëhet nga subjekte juridike, apo fizike, të regjistruar pranë QKK-së.

Çdo subjekt që kërkon të përfitojë mbështetjen e QKK, duhet të kalojë nëpërmjet vendimmarrjes së Këshillit të Miratimit të Projekteve dhe asnjë akt administrativ qoftë marrëveshje/memorandum/kontratë, etj., nënshkruar ndërmjet Qendrës Kombëtare të Kinematografisë dhe një subjekti privat, nuk mund t'i mbivendoset këtij rregulli. QKK e realizon veprimtarinë e saj nëpërmjet vendimmarrjes kolegjiale, të cilat janë Këshillat Miratues të Projekteve dhe Komisioni Financiar. Këshillat Miratuese të Projekteve vlerësojnë dhe përzgjedhin projektet nga pikëpamja artistike e ekonomike ndërsa Komisioni financiar vlerëson projektet e paraqitura nga pikëpamja financiare dhe mbikëqyr realizimin e fondit buxhetor në projektet e miratuara. Në asnjë rast ligji nuk parashikon financime të QKK-së nëpërmjet miratimit të marrëveshjeve me subjekte të tjera. Pra të dy këto organe kolegjiale janë pjesë e një zinxhiri procedural në funksion të njërit-tjetrit, si një garanci për administrimin e buxhetit të këtij institucioni.

Krahas dispozitave ligjore QKK ka pasqyruar alternativat e bashkëpunimit, të cilat mund të realizohen nëpërmjet memorandumeve të mirëkuptimit për ndjekjen e procedurave ligjore, të cilat mund të realizohen nëpërmjet :

- a) Aplikimit me projektet e studentëve, për të përfitur financimin e prodhimit të filmave të tyre.
- b) Realizimi i workshop-eve me qëllim ngritjen e nivelit profesional të studentëve / kineastëve.
- c) Mbulimi i pjesshëm, ose i plotë i bursës për studentët më të mirë të çdo viti akademik.

Nisur sa më sipër, Ministria e Kulturës por dhe Qendra Kombëtare e Kinematografisë shpreh angazhimin maksimal për të bashkëpunuar dhe ndihmuar Akademinë e Filmit dhe

Multimedias “Marubi”, brenda mundësive që krijon legjislacioni në fuqi, të cilat ekzistojnë dhe janë realisht të mundshme për t’u aplikuar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

**MINISTRI**  
**Mirela KUMBARO-FURXHI**

